Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Visar BIBAJ / Ekspert Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. lëndës:
_____	**05.05.2022**	**13.05.2022**	**121/22**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Më datën: 27.04.2022, Operatori Ekonomik "Studio Links 4" - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me numër: **121/22**, kundër propozimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Hartimi i draft planit komunal te veprimit për energji dhe klimë", me nr. prokurimi: 611-22-2019-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Drenas.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është shërbim, vlera e parashikuar: 20 000,00 €

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE ANKUES

AK ka shkelur nenin 1 dhe 7 te LPP-se.

DEKLARATA DETALE E ANKESES

Neni 1 për arsye se vendimi i A.K. date 21/04/2022 eshte keqmengjim te paras publike duke e shperblyer me kontrate OE me te shtrenjt.

Neni 7. A.K. ke bere shkelje te nenit 7 sepse ka bere diskriminim me vendim jo te drejte ndaj Operatorit Ekonomik me te lire me cmim (Studio LINKS 4) kur në vendimin e parë dt. 21.04.2022 e anulon studio LINKS 4 në arsyetimin e gabimit aritmetikor më të madh se 2%.
Në vendimin e datës 22.04.2022 sqaron që cmimi në Formularin e tenderit është 10,000 ndërsa cmimi në paramasë është 11800. Po ju bashkangjes hapjen e ofertave ku shihet cmimi pa tvsh 10,000EURO ndersa cmimi me TVSH 11,800 EURO.

AK në vendimin e saj te dyte i referohet nenit 39.8 të RRUOP. Mendojme qe është jo i drejtë te thirret ne kete nen te RRUOP-se, sepse Lista e cmimeve ose Pershkrimi i cmimeve nuk ka pasur fusha te mbyllura dhe fusha

te shenuara per tu plotesuar nga OE ne lidhje me TVSH. AK Është dashur t'i referohet nenit 24.10 te RRUOP ku thuhet:

24.10 Lista e çmimcve e standardizuar cshtc një Liste e çmimcvc që gjcncrohct nga sistcmi dhc përmban elemente të paracaktuara të Listës se çmimeve. Kjo Liste e çmimeve shkarkohet nga faqja c intcmctit të Prokurimit Publik Elektronik në Kosovë. Lista c çmimcve c standardizuar gjenerohct në fonnë të standardizuar të Excel-it ose kjo listc mund të plotësohet direkt në formën e sistemit ose, ne rast se kjo c liste e standardizuar nuk i plotëson nevojat (spccifikat e ndryshme) e AK, AK mund të krijoj një liste të re. Pas plotësimit dhc ngarkimit, Lista c çmimeve e standardizuar shndërrohet në një fonnat të Listës sc çmimcve e cila është c përshtatshmc për tcndcruesit, me fusha të mbyllura të përcaktuara nga autoritcti kontraktucs dhc mc fushat c shënuara për tu plotësuar nga ofcrtucsit:

- Çmim për njësi
- **Norma e TVSH-së**
- Emri i prodhuesit
- Shënimi i Ofertuesit

Në përshkrimin e cmimit Lista e cmimeve nuk ka pasur Normën e TVSH-së dhe rrjedhimisht ka qenë në kundërshtim me RRUOP sepse Lista e cmimeve duhet të përmbaj Normën e TVSH-së. AK nuk ka thene qe norma e TVSH-se perfshihet ne cmim apo nuk perfshihet por ka harruar ose me qellim nuk e ka vendosurfushen e shenuar per tu plotesuar nga ofertuesi.

Andaj bazuar në pyetjet e shpeshta:

Pytja e slipeslit nr.46 citat: - Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çnum ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta komgjoj % (përqmdjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkqj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë

Ne mendojmë që AK është dashur të konsultohet me Pyetjet e shpeshta sikurse kjo nr.
46 dhe të mos e eliminoj OE më të lirë në cmim vetëm sa për t'i dhënë kontratën OE të 3 me rradhë. AK ka bërë gabim në përpilimin e Listës së cmimeve.
Cmimin që ne kemi vendosur në Listën e cmimeve ka qenë në përputhje me RRUOP dhe aty ku nuk ka ekzistuar Norma e TVSH-së ne nuk e kemi vendosur normën e TVSH-së. Por pastaj Listës së cmimeve i është shtuar norma e TVSH-së në sistemin e-prokurimi në fushën e caktuar ku edhe është kërkuar nga sistemi. Shiheni ju lutem Hapjen e cmimeve. Fakti qe ne kete aktivitet te prokurimit jane ftuar te konkurojne edhe OJQ-te te cilat nuk kane TVSH mendoj qe Lista e cmimeve iu eshte pershtatur atyre. (ju lutem shiqojeni ofertuesin AKEREE i cili eshte OJQ)

KRITERET PËR VLERËSIM

Nuk kontestohen

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA EEKSPERTI SHQYRTUES.

Ska

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

NA

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Etiani Shpk & Lurn shpk - ISTOG

Sqarim Hyrës: Autoriteti Kontraktues Komuna Drenas, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është shërbim. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie te kontratës, përkatësisht kundër arsyetimit te eliminimit te Operatorit Ekonomik ankues "Studio Links4"- Prishtinë , (me teje si parashtruesi i ankesës), ku AK – Komuna Drenas përmes letrës standarde te datës 21.04.2022, tekstualisht ka potencuar: "***Ka gabime ne para masë te cilat kalojnë vlerën 2% te kontratës***".

I njëjti arsyetim është kontestuar nga parashtruesi i ankesës sipas kërkesës për ri shqyrtim. AK – Komuna Drenas, përmes përgjigjes – Vendimit te datës 22.04.2022, refuzon kërkesën si te pa bazuar dhe përmes arsyetimit te te njëjtit vendim përveç tjerash potencon se, çmimi i ofruar ne formularin e tenderit dhe ne hapje nuk është ne proporcion me çmimin ne para masë, rrjedhimisht i referohet nenit 39.8, te RrUOPP-se "Formulari i tenderit nuk është i plotësuar si duhet apo mungon". Pra AK – Komuna Drenas ndryshon arsyetimin e eliminimit.

Përgjigjeje në pretendimin ankimore 1 (neni 113) : Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se parashtruesi i ankese përmes deklaratës ne ankese potencon se ka ofertuar duke aplikuar format standarde, përkatësisht ofertën e ka ndërtuar sipas hapave te lejuar nga sistemi e-prokurimi, rrjedhimisht ne formularin për dorëzim te tenderit është përshkruar vlera e çmimit me TVSH automatikisht. Prandaj arsyetimin e tille te eliminimit te parashtruesit te ankesës e kualifikojmë si te pa bazuar pasi AK – Komuna Drenas nuk ka dhëne arsyetim konkret lidhur me gabimet aritmetike ne para mase.

- Neni 59, par 3, i LPP-se është i qarte: " Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy për qind (2%) i vlerës totale të ofertës. **Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor...”**.

Nëse i referohemi ndryshimit te çmimit ne ofertë financiare dhe ne formular te dorëzimit te tenderit AK, ka qene dashur te sqaroi dhe argumentoi 'pa përgjegjshmërinë' e parashtruesit te ankesës duke u bazuar ne dispozita ligjore ne fuqi, rrjedhimisht t'i trajtoi te gjitha ofertat siç parashihet me nenin 7, te LPP-se. Operatori Ekonomik, pjesëmarrës ne ketë procedure te prokurimit NPSH "Consult – Eng", sipas para masës ka ofertuar po ashtu me format jo standard ku pas çmimit total te ofertës ka pershruar edhe TVSH, (duke nderhyre ne para mase dhe para llogari) por i njëjti është kualifikuar si oferte e pa suksesshme jo oferte e pa përgjegjshme siç është deklaruar parashtruesi i ankesës.

- Prandaj bazuar ne atë qe u përshkrua me larte, propozimi ynë për AK – Komuna Drenas, është qe lenden ta kthej ne Ri vlerësim me qellim qe te pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave dhe te trajtohen te gjithë ofertuesit ne mënyre te barabarte, pasi qe ne para masën e ngarkuar nga AK kundrejt ofertuesve nuk është aplikuar TVSH, ndërsa ne Procesverbalin e hapjes është aplikuar dhe përshkruar vlera totale me TVSH për te gjitha pjesëmarrësit ne ketë procedure te prokurimit, përkatësisht te vërtetohet nëse parashtruesi i ankesës ka ofertuar sipas hapave te lejuar nga sistemi e-prokurimit dhe nëse vet sistemi e ka krijuar çmimin e ofertës se përshkruar ne formularin C.

<u>Si prove se bashku me raport si prova shkresore gjeni kopjet</u>:
Procesverbali i hapjes, para masa e operatoreve ekonomik te përfshire ne procedure te prokurimit

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, "Studio Links4"- Prishtine, të aprovohet si e bazuar, te anulohet propozimi për dhënie te kontratës dhe lënda te kthehet ne Ri vlerësim.

Raporti ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – “Komuna Drenas.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - Studio Links 4 - Prishtine